



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. _____ prot.

Tiranë, më 22.7.2022

Lënda: Bisedimet përfundimtare të Komisionerit Publik në seancën gjyqësore të datës 22.7.2022, para trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, për çështjen ankim kundër vendimit nr. 491/2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, z. Gjon Kodra

Drejtuar: Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

Baza ligjore: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

Të nderuar anëtarë të trupit gjykues,

Në përfundim të këtij shqyrtimi gjyqësor, në referencë të nenit 302 dhe 303 të Kodit të Procedurës Civile, në zbatim të Rekomandimit të ONM-së, duke iu qëndruar të gjitha shkaqeve të ankimit dhe parashtrimeve me shkrim të depozituara në seancën gjyqësore të datës 4.7.2022, në vlerësim edhe të provave të administruara në kuadër të këtij gjykimi, Komisioneri Publik, për secilin shkak ankimi, kundrejt prapësimeve të paraqitura, në mënyrë të përmbledhur vlerëson se:

I. Për shkakun ankimor për vlerësimin e kriterit të pasurisë

1. Në lidhje me pasurinë *Apartament me sip. 129 m²*, në Tiranë, në vlerën 50.952 euro, subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij të paraqitura në seancën e datës 4 dhe 18.7.2022, ka risjellë në vëmendje rezultatet e hetimit administrativ dhe vlerësimin përfundimtar të Komisionit, duke iu qëndruar kështu të njëjtave shpjegime të dhëna prej tij në kuadër të procesit të rivlerësimit¹.

2. Komisioneri Publik vlerëson se, edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, lidhur me këtë shkak ankimi, subjekti i rivlerësimit nuk arrin të provojë të kundërtën. Për rrjedhojë, sikundër

¹ Për më tepër referohuni aktit “Parashtrime” të subjektit të rivlerësimit, protokolluar me nr. *** prot., dhe përcjellë nga ana e Kolegjit në datën 29.6.2022, f. 21-42, të tij.

trajtuar më gjerësisht në ankim dhe në parashtrimet e seancës së datës 4.7.2022, bazuar në Rekomandimin e ONM-së, datë 25.1.2022, germa “A”, vlerësojmë se nuk mbulohen me burime të ligjshme pagesat e kryera në vitet 2006, 2007 dhe 2008, për blerjen e pasurisë *Apartament me sip. 129 m²*, ndodhur në Tiranë.

2.1 Lidhur me *pagesën e shumës 35,952 euro në vitin 2006*, edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes në Kolegj, nuk u administrua ndonjë provë/akt, që vërteton të kundërtën e sa pretendohet në ankim për shumën 35,000 euro, që mungon të jetë deklaruar dhe provuar posedimi, sipas parashikimeve ligjore. Për rrjedhojë, bazuar edhe në jurisprudencën e Kolegjit², rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të nuk mbulojnë me burime të ligjshme shpenzimet, kursimet dhe pagesën e kryer në vitin 2006, për një diferencë negative prej - 4,021,882 lekësh³.

2.2 Komisioneri Publik ndan të njëjtin qëndrim edhe për shkakun ankimor lidhur me *pagesën e shumës 5,000 euro në vitin 2007 dhe pagesën e shumës 10,000 euro në vitin 2008*, pasi, sikundër është trajtuar gjerësisht në ankim dhe në parashtrimet e seancës së datës 4.7.2022, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për pagesën e kryer për apartamentin në vitin 2007, në shumën 5,000 euro, si dhe nuk mbulojnë me burime të ligjshme pagesën e kryer në vitin 2008, shpenzimet dhe kursimet e vitit, për një diferencë negative në shumën -563.752 lekë⁴.

2.3 Duke përfunduar, Komisioneri Publik, referuar dhe qëndrimit të mbajtur mbi elementet e analizës financiare të Komisionit, përcjellë në Kolegj me shkresën nr. *** prot., datë 6.7.2022, vlerëson se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të nuk mbulojnë me burime të ligjshme pagesat e kryera në vitet 2006, 2007 dhe 2008, për pasurinë *Apartament me sip. 129 m²*, si dhe nuk mbulojnë me burime të ligjshme shpenzimet dhe kursimet për vitin 2011, sikundër konstatuar dhe nga Komisioni⁵, duke u ndodhur kështu në kushtet e deklaramit të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë, referuar nenit D të aneksit të Kushtetutës, nenit 33, pika 5, germa “b”, dhe nenit 61, pika 3, të ligjit nr. 84/2016.

II. Për shkakun ankimor mbi ekzistencën e konfliktit të interesit

3. Në funksion të shqyrtimit të këtij shkakui ankimi, Kolegji, pasi vendosi të riçelë hetimin gjyqësor, pranoi të administrojë në cilësinë e provës aktet e dorëzuara nga subjekti: (i) Urdhrin nr. ***, datë **.10.2010, “Për organizimin e prokurorëve dhe O. P. Gj.-ve”, të drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku subjekti i rivlerësimit rezulton pjesë e Seksionit kundër Vjedhjeve me Dhunë dhe Armë, me drejtues seksioni z. ***.***, dhe (ii) Deklaratën e datës **.6.2022, të prokurorit, z. ***.***.⁶

² Për më tepër, lidhur me deklaramin e kursimeve *cash*, referohuni në vendimet (JR) nr. 27/2020 dhe nr. 1/2021.

³ Referohuni rezultatit financiar të Komisionit për vitin 2006, f. 35 e relacionit mbi rezultatet paraprake të hetimit administrativ për subjektin e rivlerësimit.

⁴ Referohuni rezultatit financiar të Komisionit për vitin 2008, f. 51 e vendimit.

⁵ Referohuni analizës financiare të Komisionit, në f. 51 të vendimit.

⁶ Vërtetuar nënshkrimi nga noteria ***.***, me nr. *** rep., datë **.6.2022.

4. Subjekti i rivlerësimit, në prapësime të tij të paraqitura në seancën e datës 4.7.2022, ndër të tjera, iu ka qëndruar të njëjtave shpjegime të dhëna gjatë hetimit administrativ të Komisionit.

5. Komisioneri Publik, në analizë të akteve të administruara gjatë hetimit administrativ të Komisionit, prapësimeve dhe akteve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit pas riçeljes së hetimit gjyqësor në Kolegj, çmon se shkaqet e ankimit lidhur me ekzistencën e konfliktit të interesit mbetën të njëjta dhe subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e tyre, sa kohë nuk rezultoi të ketë ndërmarrë veprimet përkatëse, të parashikuara në dispozitat procedurale për parashtrimin e situatës, që mund të vlerësohej nga autoriteti i ngarkuar nga ligji, si shkak për pamundësinë e subjektit për të përfaqësuar organin e akuzës në procedimin përkatës.

6. Sikundër trajtuar në ankim dhe në parashtrimet e seancës së datës 4.7.2022, në zbatim të Rekomandimit të ONM-së, germa "B", Komisioneri Publik vlerëson se nga aktet e administruara rezulton se detyrimet e ndërsjella juridiko-civile, mes subjektit të rivlerësimit dhe administratorit të shoqërisë "****" sh.p.k., kanë nisur prej vitit 2006 dhe kanë përfunduar efektet e tyre në vitin 2017, moment në të cilin palët lidhin marrëveshjen dhe bien dakord përfundimisht për të drejtat dhe detyrimet e tyre reciproke.

III. Për shkakun ankimor për vlerësimin e kriterit të figurës

7. Në funksion të shqyrtimit të këtij shkak ankimor, Kolegji vendosi të administrojë në cilësinë e provës aktet e dorëzuara prej subjektit të rivlerësimit: (i) Disa procesverbale gjyqësore, të vërtetuara nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Dhoma Penale, me gjyqtar z. ***.***, në të cilat tregohet ecuria procedurale dhe vendimmarrja e kësaj gjykate lidhur me gjykimin e akuzës penale kundër shtetasit ***.***, për veprën e falsifikimit të dokumenteve; dhe (ii) Aktin "Konkluzione", të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë, për procedimin penal nr. ***, në ngarkim të pandehurit ***.***.

8. Subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e tij të paraqitura në seancën e datës 4.7.2022, ndër të tjera, iu ka qëndruar të njëjtave shpjegime të dhëna gjatë hetimit administrativ të Komisionit⁷, duke prapësuar se *kontakti ka qenë thjesht rastësor dhe një i vetëm, përmbajtja e bisedës ka qenë e pavlerë.*

9. Komisioneri Publik, duke iu qëndruar të gjitha shkaqeve të ankimit, në zbatim të Rekomandimit të ONM-së, të datës 25.1.2022, parashtrimeve me shkrim të depozituara në seancën gjyqësore të datës 4.7.2022, si dhe përmbajtjes të *Gjetjes* së vëzhguesit ndërkombëtar të ONM-së, e cila, në referencë të pikës 10, të nenit 49, të ligjit nr. 84/2016, përbën provë që dëshmon një fakt, rrethanë apo standard ligjor, vlerëson se, edhe pse natyra dhe koha e kontaktit në këtë rast përbën rrethanë lehtësuese, ajo duhet vlerësuar në kuptim të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016.

⁷ Për më tepër referohuni aktit "Parashtrime" të subjektit të rivlerësimit, protokolluar me nr. *** prot., dhe përcjellë nga ana e Kolegjit në datë 29.6.2022, f. 71-80, të tij.

10. Për sa më sipër, duke konstatuar një sërë mangësish, për kriterin e pasurisë, ekzistenca e konfliktit të interesit së bashku me problematikat për kontrollin e figurës, bazuar në një vlerësim të përgjithshëm të të tria kriterëve, apo vlerësim tërësor të çështjes, rezulton se zbatimi i nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, në rastin konkret, nuk është i bazuar.

IV. Kërkimi përfundimtar i ankimit

11. Komisioneri Publik, mbështetur në sa më sipër trajtuar dhe në Rekomandimin e ONM-së, bazuar në dispozitën e pikës 3 dhe 7, të nenit F, të aneksit të Kushtetutës, shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 66, të ligjit nr. 84/2016, kërkon nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelit të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 491, datë 21.12.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Gjon Kodra.

KOMISIONERI PUBLIK

Florian BALLHYSA